



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.111/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, departamenti i përgjithshëm e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi, me procesmbajtësen Elheme Peci në çështien juridike të paditësit:

nga _____, Rr. _____ kundër të paditurve: _____ nga Mitrovica, te cilin me autorizim e përfaqëson Av. _____ dhe _____ ish nga Mitrovica tani me vendbanim të panjohur të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm nga rradhët e avokatëve Av. _____ nga Skenderaj për shkak të vërtetimit të pronësisë, pas mbajtjes së seancës kryesore, me datë: 28.12.2017 bie këtë:

A K T G J Y K I M

I. VËRTETOHET se paditësi: _____ nga _____ është pronarë mbi bazën e mbajtjes me mirëbesim për me tepër se 20 vite i patundshmërive te cilat gjenden në Mitrovicë-Veri në vendin e quajtur: _____ pjesë te ngastrave kadastrale nr _____ me sipërfaqe prej 0.04.79ha dhe nr. _____ me sipërfaqe prej 0.00.30ha me dimensione si në skicën e terrenit që është pjesë e ekspertizës gjeodete e cila evidentohet në emër të të paditurit.

II. OBLIGOHEN te paditurit qe t'ia pranojnë dhe t'ia lejojnë paditësit që paluajtshmërite e cekura në pikën I të dispozitivit, t'i regjistroj - bart në emër të tij si pronar në regjistrat kadastral, në të kundërtën ky aktgjykim të njëjtit do t'i shërbej si titull ekzekutiv për regjistrim.

III. OBLIGOHET paditësi që në emër të taksës për përpilim të aktgjykimit te paguaj shumën prej 20 euro dhe shume prej 135 euro ne emër te një përfaqësimit nga ana e përfaqësuesit te përkohshme të të paditurit te dyte, brenda afatit 15 ditor që nga data e pranimit te këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit te detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditës me anë të padisë, ka kërkuar që të vërtetohet se është pronar mbi bazën e shitblerjes dhe mbajtjes me mirëbesim i patundshmërisë e cila gjendet në Mitrovicës.

Meqenëse për të paditurin e dyte nuk dihej vendbanimi i të njëjtit, dhe organet gjegjëse nuk posedonin me të dhëna rreth adresës së tyre, gjykata pas propozimit të paditësit në kuptim të dispozitave ligjore të paditurit ia caktoi përfaqësuesin e përkohshëm nga rradha e avokatëve.

Paditësi në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë, pajtohet me ekspertizën edhe pse deklaroi se sipërfaqja në ekspertizë është 30m² me e vogël se sipërfaqja në kohën e shitblerjes. Kërkon që secila palë ti barte shpenzimet e veta.

Përfaqësuesi me autorizim i te paditurit te pare ne fjalinë përfundimtare deklaroi se nuk e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e tani paditësit pasi që është e vërtete se klienti im ju ka shitur trojet paditësit dhe personave te tjerë te cilën përmende nga dëshmitaret dhe te njëjtëve u ka mundësuar kyçjen ne rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe ia ka mundësuar secilës ngastër qasjen ne rruge. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Përfaqësuesi i përkohshme i te paditurit te dyte ne fjalinë përfundimtare deklaroi se e kundërshtojnë padinë e paditësit ngase konsiderojnë se në rastin konkret nuk ka baze juridike që te aprovohet kërkesëpadia e palës tjetër. Shpenzimet e procedurës i kërkojnë për këtë seance.

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike u nxorën dhe u administruan këto prova: certifikata e pronësisë me nr. te njësisë 02741-9ë dt. 17.11.2014; kopja e planit dt. 23.11.2014; kopja e letërnjoftimit te paditësit; ekspertiza gjeodetë e dt. 14.08.2017; skica e terrenit dt. 02.08.2017; kopja e planit 03.03.2016; certifikata e pronësisë me nr te njësisë dhe e dt. 11.08.2017; procesverbali i daljes ne vend dt. 06.07.2017.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi një nga një dhe në raport me njëra tjetrën dhe pas vlerësimit të gjithmbarshëm të tyre aprovuan në tërësi kërkesëpadinë për këto arsye:

Nuk është kontestues fakti se prona e cila është objekt kontesti në këtë çështje juridike në regjistrat kadastral udhëhiqet në emër të të paditurve, këtë fakt gjykata e vërtetoi në bazë të certifikatës së pronësisë të lëshuar me dt.17.11.2014.

Se paditësi pjesën e parcelës tani lëndore nr. nr. me sipërfaqe prej 0.04.79ha dhe nr. me sipërfaqe prej 0.00.30ha e ka në posedim këtë fakt gjykata e vërtetoi me anë të shqisave me rastin e daljes në vend, dhe sipërfaqen e pronës në fjalë gjykata e vërtetoi me anë të ekspertizës gjeodete të cilës ia falli besimin pasi e njëjta përshkruan në mënyrë të qartë dimensionet shtrirjen dhe përkufizimin e pronës tani lëndore.

Faktin e mbajtjes me mirëbesim dhe periudhës prej më shumë se 20 vjeçare në mbajtje gjykata në mungesë të provave tjera e vërtetoi vetëm nga deklarami i dëshmitarëve: dhe të cilët me deklaratat e tyre pothuajse identike dhe të cilat deklarata u dhanë nën betim apo paralajmërim se deklarata e rrejshme paraqet vepër penale.

Madje po këta dëshmitar deklarua se ne vitet 80 këta bashke me babanë e paditësit kishin blere toka nga te paditurit, nuk ju kujtohet çmimi i parcelës lëndore, por janë te bindur se e kishte blere babai i paditësit, te cilën e kishte pasur ne shfrytëzim si bahçe, mirëpo për shkak te rrethanave ne atë kohe nuk kane mundur ta regjistrojnë ne emër te tyre.

Ajo që i bënë edhe më kredibil këta dëshmitar dhe deklaratat e tyre më të besueshme është fakti se të njëjtit nuk janë në raport familjar me paditësin por kanë qenë dëshmitar me rastin e shitblerjes.

Gjykata e aplikoi Ligjin e Vjetër pasi baza juridike ka lindur apo është sajuar në kohën kur në fuqi ka qenë ligji i vjetër, përndryshe edhe Ligji mbi Pronësinë dhe të Drejtat Tjera sendore e njëjti këtë të drejtë dhe e rregullon në formë të njëjtë.

Sa i përket të drejtës materiale gjykata u bazua në nenin 28 të Ligjit mbi marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore citoi: "Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh".

Në raport me të drejtën materiale pas vlerësimit të përgjithshëm të rrjedhës së tërësishme të procedurës dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses duhet të aprovohet në tërësi si e Bazuar, pasi me anë të provave që gjenden në shkresat e lëndës janë vërtetuar faktet vendimtare si: periudha e mbajtjes dhe mirëbesim në mbajtje, andaj mbi bazën e kësaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sa i përket shpenzimeve procedurale kjo gjykata vendosi konform nenit 450 të LPK-së si dhe konform deklaramëve të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse në procedurë, andaj gjykata vendosi që secila palë ti bart shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, gjykata konform nenit 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,
C.nr. 111/2015 me dt. 28.12.2017

GJYQTARI,
Faton Ademi



UDHËZIM PËR MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.